


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHTYPSHKRONJA "URTËSIA BEKTASHIANE" Sh.A
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E AKSIONERVE

VENDIM

Nr. 15, date 20.04 2015

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenit 15 të Statutit të shoqërisë "Urtësia Bektashiane" sh.a si dhe referuar raportit të drejtorit të shoqërisë Z.Jetmir Bodini, raportit të Këshillit Mbikqyrës si dhe diskutimeve të personave fizike, të cilët gëzojnë cilësinë e zotëruesit të aksioneve të shoqërisë gjatë mbledhjes së mbajtur në datën 20.04.2015 nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerve me pjesëmarrje 100% të aksionerve ose përfaqësuesve të tyre, të cilët zotërojnë korumin e nevojshëm ligjor:

VENDOSI:

1. Të miratojë pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 1 Janar deri me 31 Dhjetor 2014 të audituara nga shoqëria "AD- Auditing" shpk ;
2. Të shpërndajë në forme dividenti fitimin e rezultatit ushtrimor 1 janar deri 31 dhjetor 2014, në shumën neto prej 3 531 985 (tremilion e pesëqindetridhjetënjëmijëenëntëqindetëdhjetëpesë)leke, pasi janë zbritur rezerva statutore, tatimi mbi dividendin;
3. Të emërojë shoqërinë "AD-Auditing" shpk për auditimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 1 janar deri me 31 dhjetor 2015;
4. Të miratojë fondin vjetor për shpërblimin e antarëve të Këshillit Mbikqyrës në shumën prej 610,000 (gjashtëqindetdhjetëmijë) leke;
5. Riemerimin e anetareve të Këshillit Mbikqyrës Znj.Liljana Milo, Znj. Zamira Caushaj, Z.Uran Metko;
6. Të ngarkojë Drejtorin e shoqërisë "Urtësia Bektashiane" sh.a Z.Jetmir Bodini për zbatimin e këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryegjyshata Botërore Bektashiane
(zotëruesi i 80% të aksioneve)

Haxhi Baba Edmond Brahimaj

Haxhi Baba Edmond BRAHIMAJ



Kryetari i Asamblese

Uran Metko

Uran Metko